




INSTITUTI KOMBËTAR I SHËNDETËSISË PUBLIKE TË KOSOVËS



SITUATA EPIDEMIOLOGJIKE ME INFLUENCË, COVID-19 DHE PATOGENËT TJERË RESPIRATORË NË KOSOVË, SEZONA 2025/2026 (JAVA 08-TË)

Simptomet e Gripit përfshijnë:

- Temperaturë/ethe
- Kokëdhimbje
- Lodhje
- Kollë e thatë
- Dhimbje fyti
- Rrjedhje hundësh
- Dhimbje muskulare
- Simptome gastrointestinale, si nauze dhe barkqitje




PËRMBLEDHJE

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike gjatë tërë vitit bën mbikëqyrjen permanente të Influcencës sezonale (ILI), ARI dhe SARI me intensifikim të aktiviteteve gjatë sezonës përkatëse. Mbikëqyrja realizohet përmes hulumtimit aktiv dhe pasiv në institucione shëndetësore dhe terren.

**SITUATA EPIDEMIOLOGJIKE ME INFLUENCËN SEZONALE NË KOSOVË,
2021/2022 - 2025/2026**

Sipas grafikoni 1, ku janë paraqitur rastet e Influencës sezonale (ILI) në 5 sezonat e fundit shohim se sezona 2025/2026 karakterizohet me numër më të ulët të rasteve të raportura, krahasuar me periudhën e njejtë të sezonës 2024/2025 dhe fillim të aktivitetit nga java e 40-të e sezonës 2025/2026.

Grafikoni.1



**SITUATA EPIDEMIOLOGJIKE ME INFLUENCËN SEZONALE NË KOSOVË, 2025/2026
DHE PRAGU EPIDEMIK**


Nga fillimi i sezonës, 29 shtator 2025 deri më 22 shkurt 2026 (java e 08-të) në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës janë raportuar 43,903 raste të Sëmundjes të ngjashme me Grip (ILI), 6,751 raste të Infeksioneve respiratore akute (ARI) dhe 175 raste me Infeksion të rëndë respirator akut (SARI).

Gjatë javës së 08-të (16.02.2026-22.02.2026) janë raportuar 1,370 raste ILI (Sëmundje e Ngjashme me Gripin), 257 raste ARI (Infeksion Respirator Akut) dhe 7 raste SARI (Infeksion i Rëndë Akut Respirator).

Përmes sistemit të mbikëqyrjes së sëmundjeve ngjitëse dhe paralajmërimit të hershëm (SMSN) janë raportuar 325 raste ILI, 37 raste ARI dhe 7 raste me SARI.


Intensiteti i Influencës sezonale sipas numrit të rasteve të raportuara për javën e 08-të paraqitet në aktivitetin e ulët të qarkullimit dhe krahasuar me javën e kaluar shënon rritje prej 22.1%. (Graf.2)


Grafikoni.2



Në grafikoni 3 shohim se në të gjitha komunat janë raportuar raste të dyshimta në Influencë dhe sipas numrit të rasteve të raportuara, numër më të lartë kanë komuna e Prishtinës, Mitrovicës, Pejës dhe Prizrenit ndërsa sipas Incidencës numër më të lartë të rasteve kanë komuna e Kamenicës dhe Mitrovicës.


Grafikoni.3





Në raport me distribuimin e rasteve sipas grup-moshës dhe incidencës, nga numri total i rasteve të raportuara me ILI, shihet se të gjitha grup-moshat janë të atakuara derisa sipas Incidencës; grup-mosha 0-4 dhe mbi 65 vjeç. Sa i përket rasteve me ARI, grup-mosha më e atakuar është 0-4 vjeç (4,754 raste) pastaj grup-mosha 5-14 vjeç (865 raste), 15-64 vjeç (755 raste), dhe grup-mosha 65+ vjeç (377 raste). (Graf.4)


Grafikoni.4



MBIKËQYRJA VIROLOGJIKE


Në laboratorin e Qendrës Kombëtare të Influcencës – IKSHPK nga fillimi i sezonës 2025/2026 deri më 25 shkurt 2026, janë testuar gjithsej 3,465 mostra nga pacientët e qendrave sentinel dhe jo sentinel si raste të dyshimta në ILI, ARI dhe SARI. Nga mostrat e testuara 1,735 (50.1%) prej tyre të dyshimta në SARS-CoV-2 dhe 1,730 (49.9%) të dyshimta në Influcencë dhe patogjenët tjerë respiratorë. Gjatë kësaj periudhe në SARS-CoV-2 janë konfirmuar 20 raste (1.2%). Nga 1,730 mostrat e testuara në Influcencë dhe patogjenët tjerë respiratorë janë konfirmuar 331 raste me Influcencë A (pozitiviteti 19.1%). Rastet e konfirmuara me Influcencë A janë nga komuna e Prishtinës (127 raste), Mitrovicë (55 raste), Fushë Kosovë (24 raste), Ferizaj (13 raste), Podujevë (14 raste), Malishevë (14 raste), Lipjan (12 raste), Vushtri (10 raste), Drenas (8 raste), Kaçanik (6 raste), Skenderaj (6 raste), Gjakovë (5 raste), Viti (5 raste), Suharekë (5 raste), Gjilan (4 raste), Pejë (4 raste), Shtime (3 raste), Klinë (3 raste), Rahovec (2 raste), Graçanicë (2 raste), Kamenicë (2 raste), Prizren (2 raste) dhe me nga 1 rast komunitat : Novobërdë dhe Obiliq dhe i takojnë grup-moshës 0-4 vjeç (152 raste), 5-14 vjeç (85 raste), 15-34 vjeç (36 raste), 35-50 vjeç (15 raste), 51-64 vjeç (13 raste) dhe 65+ (30 raste). Gjatë javës së tetë (16.02.2026-22.02.2026), nga laboratorët private janë raportuar gjithsej 16 mostra të testuara si të dyshimta në SARS-CoV-2. Nga këto mostra nuk është konfirmuar asnjë rast pozitiv. Nga patogjenët tjerë respiratorë, janë konfirmuar: 236 mostra me RSV, 325 mostra me Human Rhinovirus, 173 mostra me Human Adenovirus, 28 mostra me Parainfluenza Virus dhe 18 mostra me Metapneumovirus (Graf.5). Rastet pozitive në RSV (13.6%), janë nga komuna e Prishtinës (92 raste), Fushë Kosovë (32 raste), Ferizaj (20 raste), Malishevë (15 raste), Podujevë (13 raste), Lipjan (5 raste), Obiliq (5 raste), Gjilan (5 raste), Vushtri (5 raste), Suharekë (5 raste), Prizren (4 raste), Viti (4 raste), Drenas (4 raste), Mitrovicë (3 raste), Kaçanik (3 raste), Shtime (3 raste), Rahovec (2 raste), Hani i Elezit (2 raste), Kamenicë (2 raste), Klinë (2 raste), Deçan (2 raste) dhe me nga 1 rast komuna: Graçanicë, Gjakovë, Istog, Novobërdë, Skenderaj dhe Pejë. Rastet pozitive me RSV i takojnë grup-moshës 0-4 vjeç (208 raste), 5-14 (13 raste), 15-34 (4 raste), 35-50 (1 rast), 51-64 (2 rast) dhe 65+ (8 raste) (Graf.5).

Grafikoni.5



Sipas subtipit: me subtipin AH3: 32 mostra apo 10%, me subtipin AH1N1: 12 mostra apo 3% dhe Influcë A të pa subtipizuar, 287 mostra apo 87%.(Graf.6.)

Grafikoni. 6



AKTIVITETET SEZONALE

IKSHPK/Departamenti i Epidemiologjisë bënë mbikëqyrjen e Influcës gjatë tërë vitit, me intensifikim të saj gjatë sezonës përkatëse (java e 40 deri në javën e 20).

Përcjell situatën epidemiologjike me rastet ILI/ARI (javore) dhe rastet me SARI (në bazë ditore/alerti).

Bënë testimin laboratorik të mostrave në Departamentin e Mikrobiologjisë/Qendrën Kombëtare për Testimin e Influcës.

Ka dhënë këshilla për popullatën për mbrojtjen nga sëmundja dhe njohjen e simptomeve të saj.

MASAT PËR PARANDALIMIN E PËRHAPJES SË VIRUSIT TË GRIPIT SEZONAL

Aktiviteti i gripit për sezonën 2025/2026, është në nivel më të ulët krahasuar me sezonën paraprake dhe masat për parandalimin dhe kontrollin e infeksioneve respiratore janë:

Mbajtja e maskave.

Distanca fizike.

Higjiena e duarve.

Evitimi i kontakteve të afërta me individë të sëmurë.

Redukimi i vizitave të familjarëve tek personat e hospitalizuar (SHSKUK, Spitalet rajonale).

Evitimi i vendeve të mbyllura dhe të mbingarkuara me njerëz.

Ushqimi i shëndetshëm me shumë vitamina.

Aktiviteti fizik dhe gjumë i mjaftueshëm.

Personat e sëmurë të qëndrojnë në shtëpi.

- Pastrimi dhe dezinfektimi i mjediseve ku qëndroni.
- Mbulimi i hundës dhe gojës me një shami gjatë teshtitjes dhe kollitjes si dhe hudhja më pas në vend të sigurt.
- Larja e duarve shpesh me ujë dhe sapun, ose solucione duarsh me alkool.
- Sytë, hunda dhe goja të mos preket me duar të kontaminuar, pasi virusi përhapet në këtë mënyrë.
- Pastrimi dhe dezinfektimi i sipërfaqeve dhe objekteve që mund të jenë kontaminuar nga virusi.

Konsultimi me mjekun për mjekimin me barna kundër gripit, të cilat duhet të merren vetëm me rekomandimin e mjekut

Medikamentet kundër gripit duhet të fillohen brenda 48 orëve të para të fillimit të sëmundjes për të pasur efektivitet të lartë.

Ato mund të parandalojnë edhe komplikimet e rënda që mund të vijnë nga gripit.

Mënyra më efikase për parandalimin e virusit të gripit është Vaksinimi me vaksinën kundër gripit.

- Vaksinimi mbron vetë personin dhe ndihmon në parandalimin e përhapjes së gripit.
- Efekti i vaksinës fillon 1 deri 2 javë pas marrjes dhe mbrojtja vazhdon rreth një vit pas vaksinimit.

VAKSINIMI

Ministria e Shëndetësisë në bashkëpunim me IKSHPK në fillim të sezonës së gripit 2025/2026 ka siguruar 85,000 doza të vaksinës sezonale dhe me fillimin e sezonës ka filluar vaksinimi sipas rekomandimeve. Deri më 31 dhjetor 2025 janë administruar gjithsej 66,314 doza të vaksinës kundër gripit sezonal. Prej tyre sipas grupeve të rrezikut: 44,347 janë administruar te grup-mosha mbi 65 vjeç, 20,142 me sëmundje kronike, 1,287 profesionistë shëndetësor, 6 gra shtatëzëna, 49 fëmijë (0-5 vjeç), 195 zyrtarë policorë dhe 30 mësimdhënës dhe të tjerë 258.

HOSPITALIZIMET

Gjatë javës së fundit nga rastet e hospitalizuara në Klinikën Infektive, Klinikën e Pediatrisë dhe spitalet rajonale janë raportuar 28 raste me ARI dhe 7 raste SARI.

Nga Klinika Infektive deri më 22 shkurt 2026, janë raportuar 5 raste të vdekjes me Influcencë A. Tre nga rastet i përkasin gjinisë mashkullore dhe dy gjinisë femërore; 4 prej të cilëve i takojnë grup-moshës mbi 65 vjeç dhe një prej tyre grup-moshës 35-50 vjeç dhe me sëmundje kronike përcjellëse.

SITUATA EPIDEMIOLOGJIKE NË RAJON DHE EVROPË

INFLUENCA SEZONALE JAVA 08/2026 NË EVROPË

Të dhënat javore nga 31 vende raportuese në Evropë tregojnë se normat e Sëmundjeve të Ngjashme me Gripin (ILI) dhe Infeksioneve Akute Respiratore (ARI) mbeten mbi nivelin bazë në 19 vende raportuese. Aktiviteti i gripit vijon të bjerë krahasuar me kulmin e hershëm sezonal, si në kujdesin parësor ashtu edhe në atë dytësor, megjithatë Influenca A(H3) mbetet virusi dominues në qarkullim dhe të rriturit mbi 65 vjeç përbëjnë përqindjen më të lartë të rasteve të rënda. Pozitiviteti për grip në rrjetin sentinel mbetet mbi pragun epidemik 10%, megjithëse në rënie krahasuar me javën e kaluar, ndërsa shumica dërrmuese e detektimeve i përkasin tipit A me bashkëqarkullim të nëntipeve A(H3) dhe A(H1)pdm09. Shumica e vendeve raportojnë intensitet mesatar ose më të lartë dhe shpërndarje rajonale apo të përhapur të gripit. Aktiviteti i SARS-CoV-2 mbetet në nivel bazë, me norma të ulëta pozitiviteti si në mbikëqyrjen e ILI/ARI ashtu edhe në SARI, dhe normat e vdekjeve nga COVID-19 raportohen të ulëta në vendet pjesëmarrëse. Ndërkohë, treguesit e RSV-së janë në nivele të rritura në kujdesin parësor dhe vijnë të mbeten të larta në kujdesin dytësor, me barrën më të madhe të sëmundjes tek fëmijët nën 5 vjeç dhe me variabilitet ndërmjet vendeve sa i përket fazës së epidemisë sezonale. Vlerësimet e përbashkëta të EuroMOMO për vdekshmërinë nga të gjitha shkaqet tregojnë nivele të rritura në javët e fundit, veçanërisht në grupmoshat mbi 65 vjeç, por me një prirje rënëse pas kulmit të arritur më herët gjatë sezonit. Sa i përket varianteve të SARS-CoV-2, XFG mbetet linja më e shpeshtë e raportuar në Rajonin Evropian gjatë muajit shkurt.

Burimi: <https://erviss.org/>